



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHENDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE  
DREJTORIA E SHERBIMIT SPITALOR LIBRAZHD

Nr. \_\_\_\_\_, prot.

Datë 25/04/2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[Data:25.04.2024]

Drejtuar: [ALCANI SHPK, nipt:J91505006Q, me adresë:Blloku Frutikulturë, Rr.Laknasit, 100 m pranë urës, Kamëz, Tiranë]

**Procedura e prokurimit:** E hapur

Numri i referencës së procedurës /Lotit: **REF-97740-03-07-2024**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** *Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:* “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet-briket)” - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik (një OE të vetëm fitues)-ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar (24 muaj)

**Fondi Limit:** 15 112 500 (Pesëmbëdhjetëmilion e njëqind e dymbëdhjetëmijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme **JO** (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.ALCANI SHPK, me numër NIPTI: J91505006Q

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera 14,430,000 (Katërmëdhjetëmilion e katërqind e tridhjetëmijë) lekë, pa TVSH.

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

2.Sulollari-Klima Shpk, me numër NIPTI: K01529003M

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 13,903,500 (Trembëdhjetëmilion e nëntëqind e tremijë e pesëqind) lekë, pa TVSH.  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. “Dru Tech” shpk, me numër NIPTI: L91419019B

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 15,015,000 (Pesëmbëdhjetëmilion e pesëmbëdhjetëmijë) lekë, pa TVSH.  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. SULOLLARI – KLIMA me numër NIPTI: K01529003M

*Emri i plotë i shoqërisë*      *Numri i NIPT-it*      *arsyet e mëposhtme*

1. Operatori Ekonomik nuk ka plotësuar piken 2.3.2 sipas kërkesës së DST -ve. OE ofertues duhet të paraqese Katalogun ose Fragmente nga Katalogu i cili është material që publikohet nën autoritetin e Prodhuesit. Për të përmbushur këtë pikë të DST -së OE ofertues ka paraqitur elektronikisht një Broshurë e punuar ne Word pa nënshkrim Administratori dhe Vulë, apo Logo Prodhuesi që të vërtetojnë lidhjen me Prodhuesin. Materiali i paraqitur në Word nuk përmbush kërkesën e pikës 2.3.2 Katalog apo Fragmente të Katalogut të Prodhuesit.

-Operatori Ekonomik nuk ka plotësuar piken 2.3.6 sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të kerkuara nga DST Shtojca 5. OE ka paraqitur elektronikisht 1 deklarate doganore nr. 1895 datë. 12.12.2022 e cila në Përshkrim Malli thotë : 1 (një) Kaldajë Peleti me peshe 990 kg. Përveç kësaj të dhëne ky dokument nuk plotëson dhe nuk jep asnjë të dhënë nga shitësi për : Fuqinë KW , Tensioni , Presioni Ujit , Motorri i Ventilatorit, Kandela ndezjes, Dimensionet, Kapaciteti i Silozit etj. Pika 2.3.6 kërkon se Kaldaja duhet të kete te gjitha specifikimet teknike sipas Shtojca 5 në DST.

-OE ka paraqitur elektronikisht një Fature TVSH –je, me nr.271 datë. 15.1.2017 e cila ne pershkrimin e mallit thotë: Kaldaja Peleti 500 kw 2 copë , e cila nuk ka të bashkangjitur nga shitësi Specifikimet Teknike të kaldajave per te permbushur Shtojca 5 e DST -së që përmban të gjitha të dhënat për kaldajat.

-OE ka paraqitur elektronikisht një deklaratë doganore nr.3165 datë.30.11.2017 e cila ne pershkrim malli thotë: 1 Kaldaje 400 KW e çmontuar. Per kete kaldaje nuk ka te specifikuar nese është kaldajë peleti, nafte, apo gazi etj. Apo çdo të dhënë tjetër që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor. Fuqia 400 Kw e shënuar nuk përputhet me fuqinë e kërkuar në DST përkatësisht 250-300 KW dhe 500-581 KW. Specifikimet Teknike bashkëngjitur mungojnë për të përmbushur Shtojcën 5-së të DST -së. -OE ka paraqitur elektronikisht një deklaratë doganore nr.668 datë.02.04.2020 e cila në përshkrim malli thotë: Brucator për kaldaja = 3 copë. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar qartë në DST dhe sipas specifikimeve teknike Shtojca 5, llojin e Kaldajave që duhen montuar për të siguruar ngrohjen e ambjenteve të spitalit. Përshkrimi në deklaratë nuk tregon nëse është kaldajë apo pjesë kaldaje e çmontuar si dhe nuk ka asnjë përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe Shtojca 5.

-OE ka paraqitur elektronikisht një deklaratë doganore nr.138 datë.30.07.2020 e cila në përshkrim malli thotë: 1 copë EN 400 KW=1116 KG dhe 1 copë EN 69 KW=185 KG, kazan kaldaje me mbulesë metalike dhe panel kontrolli 2 copë. AK ka kërkuar qartë në DST pika 2.3.6, ku kërkohen 2 kaldaja peleti me fuqi 250-300 kw dhe 2 kaldaja peleti 500-581 kw dhe jo si në përshkrim të deklaratës doganore 400 kw dhe 69 kw. Gjithashtu mungojnë bashkëngjitur të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 5.

-Për pikën 2.3.7 të kërkuara në DST -të, OE ka paraqitur elektronikisht Fletë-Analizën e mallit Objekt Prokurimi Nr.469/24 Dt.20.03.2024. Në këtë Fletë-Analizë vërehen pasaktësi në Rezultatet e Analizës përkatësisht: Densiteti  $\leq 670$  , Qendrueshmeria  $\geq 97.5$  , Vlera Kalorifike  $\geq 18.0$ . Rezultati i testimit të mallit duhet të pasqyrohet në Fletë-Analizë me vlerë fikse ashtu sikurse janë pasqyruar rezultatet për parametrat e tjera si : Diametër 6.09, Gjatësi 23.12, Lageshtira 6.36, Hiri 0.43 etj. Fletë-Analiza konsiderohet e pasaktë, pasi nuk ka rezultatet fikse të fituara për parametrat e kërkuar nga testimi në mënyrë që të vërehet përputhshmëria me kërkesat e DST – së, Shtojca 5 e si rrjedhojë mospërmbushjen e pikës 2.3.7 të DST – së, Shtojca 5.

-Pika 2.3.10 e DST -së thotë:

OE duhet të paraqesë mostrën në paketim original për mallin objekt prokurimi dhe se duhet të jetë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara. Në website e prodhuesit dhe në dokumentacionin e paraqitur elektronikisht nga OE vërehet se mostra e dorëzuar nuk është mostra origjinale e prodhuesit. Mostra origjinale ka të stampuar Logon, Emrin, Adresën dhe të dhëna të tjera të prodhuesit. Mostra e paraqitur nga OE është një thes plastik transparent pa asnjë nga stampimet identifikuese të prodhuesit i cili ka lëshuar autorizim prodhuesi për këtë operator.

Gjithashtu specifikimet teknike që janë fotokopje e Fletë-Analizës e cila ishte e pasaktë në rezultatet e testimit të mallit për Parametrat e Densitetit, Qëndrueshmërisë dhe Vlera Kalorifike bëjnë të pamundur krahasimin me specifikimet teknike të kërkuara në DST – të, Shtojca 5 për mallin e kërkuar, kështuqë pika 2.3.10, konsiderohet e pasaktë dhe e papërmbushur.

2. “Dru Tech” shpk, me numër NIPTI: L91419019B

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

*arsyet e mëposhtme*

Operatori ekonomik, nuk ka paraqitur mostër të produktit objekt prokurimi, sipas kriterit të veçantë të kualifikimit:

**Pika 2.3.10 e DST – së, thotë:** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) deri në 1 (një) ditë para hapjes së ofertave në vëndin e caktuar në dokumentat e tenderit, (sekretarinë e institucionit) nga jo më pak se një kampion në paketim original për produktin objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të ketë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër emrin e artikullit , numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emërin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostra duhet të jetë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm: [**ALCANI SHPK, nipt:J91505006Q, me adresë:Blloku Frutikulturë, Rr.Laknasit, 100 m pranë urës, Kamëz,**

**Tiranë], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 14,430,000 lekë [Katërbëdhjetëmilion e katërqind e tridhjetëmijë], pa TVSH / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek [Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd, Rruga “Jakup Biçaku”, Lagjia Nr.2, Librazhd, Protokolli i Institucionit, kati i dytë i ndërtesës], brenda 5 ditëve nga data e marrjes/publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur Marrëveshjen Kuadër.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**DREJTOR**

**Fatbardha QATJA**